FEDERATA E SPORTIT SHKOLLOR
SCHOOL SPORTS FEDERATION

Mbështetur në nenin 9.4 të Statutit të FSSHK-së, Këshilli mbikëqyrës i FSSHK-së bëri kontrollimin e pasqyrave financiare të FSSHK-së për periudhën kohore në mes të dy kuvendeve dhe raportin e auditimit. Komisioni i lartcekur që sipas Statutit të FSSHK-së është Këshilli Mbikëqyrës mbajti mbledhjen e vet me datë 03.09.2026, analizoj dhe shqyrtoi tërë dokumentacionin e nevojshëm si bazë për konkludim të vet. Dokumentacioni i trajtuar konsiderojmë se është i mjaftueshëm dhe valid për të krijuar bindjen e domosdoshme për vlerësim nga ana e këtij Këshillit.

Këshilli pas trajtimit të këtij dokumentacionit njëzëri ra dakord të paraqes këtë:

RAPORT I KËSHILLIT MBIKQYRËS

Dokumentacioni i përgatitur dhe i prezantuar, të cilin e kemi trajtuar na bind se paraqet saktësi të mjaftueshme si në evidentimet, ashtu edhe në pasqyrat financiare të periudhës raportuese.

- Pasqyrat financiare të FSSHK-së janë korrekte, bilanci i gjendjes dhe pasqyrat e të ardhurave si dhe shpenzimet paraqesin një pamje të saktë dhe reale në të gjitha aspektet materiale të pozicioneve financiare.

- Veprimet dhe operacionet, sa kemi arritur të vlerësojmë janë kryer në harmoni me rregullat financiare të aplikueshme në Kosovë. Jemi të bindur se në të gjitha transaksionet janë respektuar dhe zbatuar procedura ligjore dhe ato administrative si dhe vendimet që ka miratuar FSSHK-ja. Pra vlerësojmë se të gjitha operacionet janë realizuar në përputhshmëri të plotë me dispozitat në fuqi.

- Komisioni pati në dispozicion të gjithë dokumentacionin e duhur

- Vlerësojmë se i tërë dokumentacioni financiar është sistemuar dhe ruajtur në mënyrë shumë korrekte.

- Kemi vlerësuar se në raportet dhe pasqyrat e përgatitura nuk ka gabime materiale dhe as veprime të paligjshme.

FEDERATA E SPORTIT SHKOLLOR
SCHOOL SPORTS FEDERATION

- Kemi konstatuar se të gjeturat janë në përputhje me raportin e pasqyrave të Bordit për këtë periudhë kohore.

- Moralisht e shohim të arsyeshme që ti shprehim mirënjohje personalit për korrektësinë dhe gatishmërinë, për bashkëpunimin që ka treguar, si dhe për qëndrim korrekt gjatë kontrollit që kemi bërë.
- Duke u mbështetur në të dhënën se nuk ka pasur asnjë vërejtje as nga Shoqatat dhe palët tjera të interesuara, konsiderojmë se aktiviteti i FSSHK-së ishte në përputhje me rregulloret dhe Statutin e FSSHK-së.

Prishtinë,

03.09.2026

Anëtarët e Këshillit (komisionit) Mbikëqyrës

Ganimete Hajdari – kryetare_____

Dibran Kastrati – anëtar_____

Basri Jashari- anëtar_____